



VENDIM

Nr. 25, Datë 16.02.2016

**MBI
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HEC TERVOLI”
SH.P.K., PËR LËNIE SI GARANCI HIPOTEKORE PRANË
RAIFFEISEN BANK, TË ASETEVE QË DISPONON**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, 110 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 7 dhe 11, të Rregullores për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit, miratuar me vendimin nr.89, datë 13.12.2006, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licensës “Për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.02.2016, mbasi shqyrtoi kërkesën për lënien si garanci hipotekore të asetëve të shoqërisë “HEC TERVOLI” sh.p.k pranë Raiffeisen Bank, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “HEC TERVOLI” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit si më poshtë:

- Neni 7, pikat 1.1 dhe 1.2 (Ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.)
- Neni 7, pika 1.3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h” (Ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.)
- Neni 7, pika 2, 3, 4 dhe 5 (Ky informacion është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.)
- Me vendimin Nr.163 datë 28.12.2015, Bordi ERE-s, ka vendosur fillimin e procedurave për lënien peng. Gjatë hetimit nga ana e ERE është konstatuar

se subjekti ka hyrë në marrëveshje me Bankën për të lënë asetet që disponon, si garanci hipotekore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi :

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “HEC TERVOLI” sh.p.k për lënie si garanci hipotekore pranë Raiffeisen Bank, të aseteve që disponon si me poshte :
 - a) Gjeneratori elektrik, panelë elektrike, turbina, nënstacion elektrik,
 - b) Pasuri e paluajteshme, 1028 m² ndërtim, referuar çertifikatës të pronsisë me Nr.224065
 - c) Central Elektrik, pasuri e paluajteshme sip 4950m², çertifikate pasurie nr.268960,
 - d) Central Elektrik, pasuri e paluajteshme 3800m², çertifikate pasurie nr.268962

2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.